



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



DREJTORIA E BUJQËSISË

THIRRJE PËR APLIKIM

PËRKRAHJA E FERMERËVE PËR MBJELLJET VJESHTORE 2022

Duke u bazuar në Vendimin e Kryetarit të Komunës së Prishtinës, nr. 156/01-202936/22, të datës, 23.08.2022, ftojme fermerët e komunës së Prishtinës të aplikojnë për subvencione, pagesa direkte, për mbjellje vjeshtore - kultivim i grurit 2022.

Fermerët që do të përkrahen duhet t'i plotësojnë këto kriterë:

- Të kenë të mbjellë me grurë sipërfaqe prej 0.50 ha deri në 2.00 ha;
- Sipërfaqëja e mbjellë me grurë duhet të jetë në territorin e komunës së Prishtinës;
- Aplikuesi duhet të jetë banorë i komunës së Prishtinës;
- Do të përkrahen edhe fermerët që kanë marrë pronën me qira.

Dokumentacioni i nevojshëm:

- Kopja e një dokumenti identifikues valid i Republikës së Kosovës;
- Konfirmimi nga banka për xhirollogarinë bankare;
- Certifikata e pronësisë, 2022;
- Marrëveshja në mes qiradhënësit dhe qiramarrësit.

Data e aplikimit prej 04.10.2022 deri më 17.10.2022